



Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit me efekt nga 1 Marsi 2017 nga dhe në mes të Korporatës Energjetike të Kosovës, Sh.a.

(Tani e tutje i referohemi si “KEK-u” apo si “Kompania”)

-dhe-

zt. Arben Gjukaj

(Tani e tutje i referohemi si “zt. Gjukaj”)

(secila ndaras si “Palë” dhe së bashku si “Palët”)

Tani, prandaj, Palët me këtë pajtohen si në vijim:

1. EMËRIMI

1.1 KEK-u me këtë emëron zt. Arben Gjukaj si Drejtor Menaxhues në KEK¹, dhe zt. Gjukaj me këtë pranon punën e tillë në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje duhet të lexohet në përputhje me, dhe me këtë inkorporon kushtet e përgjithshme të punësimit të aplikuara te të gjithë punëmarrësit e KEK-ut, duke përfshirë pa kufizim: Kodin e Punës, Kodin e Etikës dhe Kodin Disiplinor të KEK-ut. Sidoqoftë, në rast të ndonjë konflikti apo paqartësie në mes të kushteve të kësaj Marrëveshjeje dhe kushteve të përgjithshme të punësimit të aplikuara për të gjithë punëmarrësit e KEK-ut, kushtet e kësaj Marrëveshjeje do të mbizotërojnë.

1.2 Varësisht nga Neni 3.1, është dakorduar që KEK-u mund të ri-emëroj zt. Gjukaj në një vend pune apo pozitë të punës tjetër brenda KEK-ut apo një kompanie si-motër, pavarësisht nëse pozita apo zyra e tillë është inferiore me pozitën e Drejtorit Menaxhues, dhe kjo nuk do të përfaqësojë shkelje të kësaj Marrëveshjeje.

¹ Pozita e ‘Drejtorit Menaxhues’ do të jetë ekuivalente me atë të ‘Kryeshelit Ekzekutiv’ për qëllim të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr. 2008/03-L-087).

2. DETYRAT DHE AUTORIZIMET

- 2.1 Detyrat dhe përgjegjësitë e zt. Gjukaj do të përfshijnë kryerjen e të gjitha detyrave të rëndomta të Drejtorit Menaxhues, për aq sa janë të theksuara në përshkrimin e vendit të punës të bashkangjitur me këtë Marrëveshje. Detyrat dhe përshkrimi i lartpërmendur i vendit të punës duhet të nxjerrët, dhe lexohen në ndërlidhje me dispozitat e dokumenteve në vijim:
- (a) Dokumentet Korporative të KEK-ut, përkatësisht Rregullorja, Kodi Qeverisjes Korporative, dhe Kodi i Etikës; dhe
 - (b) dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr. 2008/03-L-087) (“Ligji i NP”), dhe ndonjë amendament apo ndryshim të tyre.
- 2.2 Pa paragjykim të përgjegjësive të lartpërmendura, në kapacitetin e tij si Drejtor Menaxhues, zt. Gjukaj është përgjegjës për menaxhimin, zhvillimin dhe efektshmërinë e afarizmit të KEK-ut, dhe i përgjigjet Bordit të Drejtorëve të KEK-ut për performancën e afarizmit të KEK-ut.
- 2.3 Veçanërisht, zt. Gjukaj pritët të përmbush dy objektivat kryesore në vijim si Drejtor Menaxhues i KEK-ut:
- (a) Të i përmbush të gjitha caqet dhe synimet e Planit Afarist të KEK-ut dhe raportoj te Bordi i Drejtorëve në baza tre mujore rezultatet e arritura; dhe
 - (b) Të implementoj strategjinë e Qeverisë së Kosovës për shthurjen ligjore të KEK-ut dhe privatizimin pasues, duke përfshirë implementimin në kohë të të gjitha ndryshimeve të nevojshme në personelin dhe skemën organizative të KEK-ut.
- 2.4 Zt. Gjukaj do i kërkohet gjithashtu të marrë një rol aktiv në zhvillimin e personelit të KEK-ut dhe të i motivojë ata përmes një udhëheqjeje shembullore.
- 2.5 Zt. Gjukaj do të kushtojë të gjithë kohën e tij produktive, aftësinë dhe vëmendjen në menaxhimin e afarizmit të KEK-ut dhe do të kryejë detyrat e tij në mënyrë profesionale, etike dhe afariste. Në këtë kontekst, zt. Gjukaj gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje nuk do të angazhohet drejtpërdrejt apo jo drejtpërdrejt në çfarëdo veprimtarie tjetër, çoftë si punëmarrës, punëdhënës, zyrtar, drejtor, apo në ndonjë kapacitet tjetër pa miratimin paraprak me shkrim nga Bordi i Drejtorëve të KEK-ut, dhe miratimi i tillë nuk duhet të jepet nëse ka apo mund të ketë mundësi për konflikt të interesave.
- 2.6 Varësisht nga parametrat e theksuar në Ligjin e NP dhe Dokumentet Korporative të KEK-ut, zt. Gjukaj e bart, dhe do të ekzekutoj autoritetin e plotë mbi menaxhimin e veprimtarisë afariste të KEK-ut, që pasqyrojnë përgjegjësitë e tij të gjëra për performancën e Kompanisë.

3. FLEKSIBILITETI NË PUNË

- 3.1 Zt. Gjukaj pritët të jetë fleksibil në lidhje me vendin e punës dhe lokacionin e vendit të punës. Siç është theksuar në Nenin 1.2 të kësaj Marrëveshjeje, me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje zt. Gjukaj ka pranuar se ai është në dispozicion për ri-emërim nga KEK-u në çfarëdo pozite menaxhuese apo

tjetër brenda Kompanisë, apo një kompanie si motër, që përputhet me kualifikimet e tij dhe nivelin e eksperiencës, me kusht që paga e cila do ti caktohet nuk duhet të jetë më e vogël se 2/3 e pagës aktuale. Zt. Gjukaj do të konsultohet para ndonjë propozimi për ri-emërimi apo ndërrimi të lokacionit të punës për të cilën ai nuk ka aplikuar, dhe do të merren në konsiderim të plotë rrethanat e tij personale para marrjes së vendimit përfundimtar.

3.2 Zt. Gjukaj do të kërkohet të udhëtoj brenda dhe jashtë Kosovës në masën e nevojshme për të përmbushur në mënyrë të duhur detyrat e tij si Drejtor Menaxhues.

4. KONFLIKTI I INTERESIT & ETIKA

4.1 Zt. Gjukaj do të respektojë rreptësisht rregullat mbi konfliktin e interesit të theksuara në Kodin e Etikës të KEK-ut, dhe ai duhet të nënshkruajë dhe kompletojë të gjitha deklaratat e aplikueshme dhe format e bashkangjitura në Kodin e theksuar të Etikës para se kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi.

5. KOMPENZIMI

5.1 Në konsiderim të punës si Drejtor Menaxhues, zt. Gjukaj do të i takojë kompensimi në vijim:

- (a) Një pagë mujore bazë (bruto) prej EUR ~~1000~~ (€) e pagueshme sipas orarit të pagesave të pagave të KEK-ut. Niveli i pagës është personal dhe konfidencial, dhe si i tillë është një çështje mes zt. Gjukaj dhe Bordit të Drejtorëve të KEK-ut.
- (b) Një pagesë vjetore stimuluese deri në 21% të pagës bazë bruto vjetore e pagueshme në fund të çdo viti fiskal. Niveli i pagesës stimuluese, nëse ndonjë, do të përcaktohet nga Bordi i Drejtorëve të KEK-ut, bazuar në vlerësimin e performancës të kryer nga Komiteti i Auditit në fund të çdo viti fiskal. Përveç se, në rast të shkëputjes të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me Nenin 7.4(a), vlerësimi do të ndërmerret në ditën e shkëputjes.
- (c) Pjese përbërëse e kësaj Marrëveshjeje do të jete edhe objektivat e performancës të caktuara nga bordi në baze vjetore, dhe sipas parimeve të caktuara në Nenin 5.1(d) me poshtë.
- (d) Në lidhje me Nenin 5.1(b), vlerësimi do të fokusohet në nivelin e performancës në tri fushat kyçe, përkatësisht: (a) performance individuale e zt. Gjukaj; (b) performanca e përgjithshme e KEK-ut; dhe (c) performanca e secilit Divizionit të KEK-ut. Indikatorët e performancës për secilën prej këtyre fushave do të bazohen në caqet e theksuara në planin vjetor afarist të KEK-ut. Për më tej, performanca individuale e zt. Gjukaj do të vlerësohet kundrejt Ceqeve Personale, të cilat do të pajtohen me zt. Gjukaj.

6. PËRFITIMET

6.1 Zt. Gjukaj i takojnë përfitimet në vijim:

- (a) Festat Zyrtare: zt. Gjukaj, i takon pushimi me pagesë gjatë Festave Zyrtare, të cilat janë të theksuara në Ligjin për Festat Zyrtare (Nr. 03/L-064). Ditët për Festat e caktuara Zyrtare mund të ndryshojnë nga viti në vit dhe do të konfirmohen me 31 janar të vitin në fjalë. Nëse

një Festë Zyrtare i bie në ditën e shtunë apo të diele, pushimi me pagesë do të jetë dhe aplikohet për ditën e hënë në vijim.

- (b) Pushimi: Zt. Gjukaj i takon pushimi me pagesë në përputhje me kushtet e përgjithshme të punësimit për punëmarrësit e KEK-ut.
- (c) Zt. Gjukaj gjithashtu i takon pushimi me pagesë në rastet tjera të përshkruara në kushtet e përgjithshme për punësim për punëmarrësit e KEK.
- (d) Sigurimi Shëndetësor: KEK-u pajtohet të përfshijë zt. Gjukaj në çdo plan shëndetësor që bëhet për punëmarrësit e tij.
- (e) Fondi Pensional: Zt. Gjukaj do të i takojë pjesëmarrja në çfarëdo plani pensional të adaptuar dhe operuar nga KEK-u për përfitimin e punëmarrësve të tij.
- (f) Kompensimi i Shpenzimeve: Zt. Gjukaj do të i takojë kompensimi për të gjitha shpenzimet e arsyeshme, duke përfshirë udhëtimet dhe dëfrimet, e shpenzuara sipas rregullave gjatë ekzekutimit të detyrave të tij, dhe të cilat janë në përputhje me kushtet e përgjithshme të punësimit për punëmarrësit e KEK-ut.

6.2 Një automjet i përshtatshëm do të i jepet zt. Gjukaj, të cilin pritet që ai ta ngasë personalisht apo edhe me shoferë gjatë orarit zyrtar të punës. Përdorimi i automjetit të lartpërmendur nga zt. Gjukaj do të bëhet në përputhje me kushtet e përgjithshme të punësimit për punëmarrësit e KEK-ut dhe ndonjë rregulle apo rregulloreje për përdorimin e automjeteve që është në fuqi.

7. KOHËZGJATJA DHE SHKËPUTJA

7.1 Varësisht nga përmbushja e kushteve të theksuara në Nenin 4.1, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga të dyja Palët me efekt nga 3 Maj 2017. Kjo marrëveshje është bërë pa kohëzgjatje të kufizuar dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi deri në shkëputjen e saj sipas Nenit 7.3 më poshtë, si dhe në harmoni me dispozitat e Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, Ligjit të Punës, dhe politikat e KEK-ut.

7.2 Pa paragjykuar këto që u thanë më lart, kjo Marrëveshje mund të shkëputet në rrethanat si në vijim:

- (a) Në zgjedhjen e vetme të Bordit të Drejtorëve të KEK-ut pa ndonjë arsyeje, në çfarëdo gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes në përputhshmëri me nenin 7.1 të Ligjit të punës në fuqi, ligjit nr. 03/L-212 (Koha e Njoftimit). Me kusht që, në këtë rast zt. Gjukaj do të i paguhet një pagesë prej (12) (dymbëdhjetë) pagave mujore bazë për ndarje nga puna. Çfarëdo pagese nxitëse vjetore e detyrueshme duhet gjithashtu të paguhet në baza proporcionale të vlerësuara në ditën e shkëputjes. Data e shkëputjes duhet të theksohet në njoftimin e dhënë nga Bordi i Drejtorëve të KEK-ut.
- (b) Nga zt. Gjukaj, në zgjedhjen e tij të vetme dhe në çfarëdo kohe gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes, me të dhënë të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë njoftim paraprak të KEK-u. Me marrjen e njoftimit për shkëputje, KEK-u rezervon të drejtën që menjëherë të shkëputë këtë Marrëveshje dhe paguajë zt. Gjukaj, pagën bazë për pesëmbëdhjetë ditë, dhe të i paguhet një pagesë prej (12) dymbëdhjetë pagave mujore bazë për ndarje nga puna.

(c) Nga Bordi i Drejtorëve të KEK-ut, nëse vërtetohet se zt. Gjukaj, ka kryer njërin nga veprimet në vijim:

- (i) Ka neglizhuar seriozisht detyrat e tij;
- (ii) Është përfshirë në praktika të pandershme, apo seriozisht ka dëmtuar reputacion apo qëndrueshmërinë e KEK-ut;
- (iii) Është dënuar për çfarëdo veprë penale apo është përfshirë në ndonjë akt imoral; apo
- (iv) Ka kryer shkelje serioze (siç e definuar nga Kodi Disiplinor i KEK-ut).

Në rast se zt. Gjukaj, ka kryer ndonjërin nga veprimet e lartpërmendura, KEK-u duhet të shkëpusë këtë Marrëveshje me efekt të menjëhershëm, në përputhje me Kodin Disiplinor të KEK-ut, dhe zt. Gjukaj duhet të i paguhet vetëm pagesa prej (12) (dymbëdhjetë) pagave mujore bazë për ndarje nga puna dhe paga e aplikuar bazë deri në, dhe duke përfshirë ditën e shkëputjes. Zt. Gjukaj, nuk do të paguhet me ndonjë pagesë nxitëse.

7.3 Me datën e mbarimit të punësimit, apo shkëputjes së mëhershme të kësaj Marrëveshjeje, zt. Gjukaj nuk do të jetë më punëmarrës i KEK-u dhe duhet menjëherë të i kthejë gjësendet vijuese në KEK:

- (a) Të gjithë çelësat e automjeteve, zyrave, kabineteve, ndyrëve, etj. që i takojnë KEK-ut;
- (b) Kartelën Identifikuese të KEK-ut;
- (c) Të gjitha dokumentet e KEK-ut, të dyja kopjet e forta dhe elektronike; dhe
- (d) Të gjitha veglat e KEK-ut, përfshirë kompjuterët (laptopët, etj.) dhe telefonat e dorës të dhënë nga KEK-u.

Çfarëdo pagese e mbetur apo pagesa tjera të detyruara ndaj zt. Gjukaj, nuk do të paguhet nga KEK-u nëse nuk janë përmbushur kushtet e theksuara në Nenin 7.3 ketu.

8. NJOFTIMET

8.1 Çfarëdo njoftimi i kërkuar nga kjo Marrëveshje apo i dhënë në lidhje me këtë duhet të jetë me shkrim dhe duhet të jepet te Pala tjetër me dërgesë personale apo duke përdorur email adresën vijuese:

Për KEK-un:

Drejtori i Burimeve Njerëzore të KEK-ut, Rr. Nena Terezë Nr. 36, Prishtinë, Kosovë

Për zt. Gjukaj:

Vendi i tyre i punës ose adresa e shtëpisë.

9. MARRËVESHJA NË TËRËSI

9.1 Kjo Marrëveshje përbën marrëveshjen e plotë dhe të vetme në mes të Palëve në lidhje me objektin e saj. Përveç në rastin e ripërtëritjes në këtë Marrëveshje, kjo Marrëveshje zëvendëson dhe anulon çfarëdo deklarate para-kontraktuale apo çfarëdo marrëveshje të mëhershme për punësim në mes të Palëve. Për më tej, zt. Gjukaj pranon, dhe pajtohet që ai/ajo nuk duhet të ketë disa kontrata pune në të

njëjtën kohë me KEK-un. Prandaj, sapo që zt. Gjukaj nënshkruan këtë Marrëveshje, të gjitha kontratat para-ekzistuese të punës në mes të zt. Gjukaj dhe KEK-ut do të shkëputen automatikisht dhe mund të mos ripërtërihen me skadimin e afatit apo shkëputjen e kësaj Marrëveshje.

9.2 Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshje nuk do të jetë i efektshëm përveç nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga Palët.

10. LIGJI I ZBATUESHËM

10.1 Kjo Marrëveshje duhet të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.

11. ZGJIDHJA E KONTESTIT

11.1 Palët pajtohen që ata do të shfrytëzojnë të gjitha përpjekjet e tyre për të zgjidhur në mënyrë miqësore çfarëdo kontesti të ngritur nga, apo në lidhje me këtë Marrëveshje. Çfarëdo polemike, pretendimi apo kontesti që nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore duhet të zgjidhet para Gjykatës Themelore në Prishtinë.

NË DËSHMINË E KËTYRE Palët këtu kanë pranuar këtë Marrëveshje nga data e nënshkruar së pari më poshtë.

Emri: Zt. Berat Rukiqi
Pozita: Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të KEK-ut
Për, dhe në emër të KEK-ut

Nënshkrimi:

Data:

Emri:

Nënshkrimi:

Data:

Zt. Arben Gjukaj

